



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT - Njoftim për medime -

Shkup, 21.04.2021

### Ministria e Kulturës shpenzoi 379 milion denarë për 599 mijë libra të botuar, a të pa shpërndarë

*ESHR me revizionin e kryer në Ministrinë e Kulturës konkludoi se në ministri që nga viti 2009 kanë filluar 11 projekte kapitale për botimin e librave, disa prej të cilave janë ende në proces e sipër. Përfundimisht me vitin 2019, 599,086 libra janë mbajtur në magazinë, të cilat nuk janë shpërndarë tek përdoruesit përfundimtarë, ndërsa janë shpenzuar mjete në vlerë prej rreth 379 milion denarë.*

Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizion të pasqyrave financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë në Ministrinë e Kulturës për vitin 2019, në përputhje me Programin vjetor për punë të ESHR-së për vitin 2020.

Revizorët në raportin përfundimtarë të revizionit të publikuar konstatojnë gjendje të caktuara edhe atë:

- Transferimet kapitale tek njësitë e vetëqeverisjes lokale nuk janë bërë në përputhje me dispozitat ligjore, gjegjësisht ka raste ku një komune nuk i janë paguar fonde për projektin edhe pse është dorëzuar dokumentacioni i nevojshëm, ndërsa një komune tjetër i janë paguar fonde pa dokumentacionin e kërkuar për një projekt që realisht nuk mund të realizohej deri në fund të vitit;
- Ministria e Kulturës nuk ka miratuar një plan vjetor për realizimin e interesit kombëtar në kulturë, për përcaktimin e drejtimeve të përgjithshme për realizimin e interesit kombëtar;
- Ministria e Kulturës ka paguar 406 milion denarë për financimin e aktiviteteve në fushën e kulturës përdoruesve të përzgjedhur në konkursin vjetor, pa miratuar akte të brendshme me kushte dhe kriteret të përcaktuara për mënyrën e alokimit të fondeve për projekte me interes kombëtar në fushën e kulturës për vitin 2019.

Në raportin e revizionit gjithashtu janë konstatuar disa parregullsi në alokimin e fondeve për projekte me interes kombëtar në fushën e kulturës për aktivitete të caktuara, edhe atë:

- nuk parashikohet konkurs / aplikim i veçantë për manifestime kulturore artistike dhe nuk përcaktohen kriteret të veçanta për vlerësimin e manifestimeve;
- shumica e kostove për projektet e financuara paguhen si honorarë për organizatorët e ngjarjeve;

- për disa veprimtari nuk respektohet afati i parashikuar për dorëzimin e një raporti me projekt propozime për përzgjedhje nga komisioni i formuar nga ministri;
- janë paguar mjete për projekte me dokumentacion jo të plotë, pa raport të dorëzuar për realizimin e projektit, si dhe pagesa të mjeteve në para në shuma që tejkalojnë kufirin e lejuar ligjrisht.

Revizorët zbuluan se Ministria e Kulturës nuk ka kryer inventarizim të mjeteve dhe burimeve të mjeteve në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore, për shkak të të cilave nuk është harmonizuar gjendja e librave të kontabilitetit me gjendjen faktike.

Gjithashtu, në pjesën e raportit të revizionit që i referohet Theksimit të çështjeve që kanë të bëjnë me pasigurinë dhe vazhdimësinë shpalosen gjendje që mund të shkaktojnë implikime financiare në të ardhmen, si më poshtë:

- në dhjetor të vitit 2018, me konkluzion nga Qeveria e RMV-së, janë dhënë udhëzime që ministria të ndërmarrë hapa për ndërprerje miqësore të kontratës së prokurimit publik për punimet e ndërtimit të EN Teatri i Dramës - Shkup, sepse ky objekt nuk paraqet prioritet strategjik për Qeverinë e RMV-së, si dhe mjetet e nevojshme financiare për të, nuk janë siguruar, si dhe
- Ministria e Kulturës si investitor për ndërtimin e Objektivit me Kompozicion Skulpturor në Shkup, në vitin 2015 ka lidhur kontratë të prokurimit publik për ndërtimin e objektit në vlerë prej 342 milion denarë, me periudhë ndërtimi prej 18 muaj dhe një kontratë për mbikëqyrje në vlerë prej 528 mijë denarë. Që nga gushti i vitit 2017, të gjitha aktivitetet e ndërtimit janë pezulluar nga sipërmarrësi. Në janar të vitit 2019, Qeveria e RMV-së me konkluzion udhëzon Ministrinë e Kulturës të zhvillojë procedurë për shndërrim të këtij objekti dhe të shpallë konkurs publik për zgjidhje ideore.

Në pjesën e çështjeve të tjera, revizioni arriti në përfundimin se pagat e të punësuarve në kulturë janë paguar duke rritur koeficientët dhe duke ndryshuar bazën me të cilën rritet pagesa e pagës, në ndërkohë që për të njëjtën nuk është bërë ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Pagesën e Pagave në RMV.

**Link deri tek raporti: Raporti përfundimtar i revizionit të kryer mbi pasqyrat financiare dhe revizionit të pajtueshmërisë në Ministrinë e Kulturës.**

**Press kontakt:**

**Mijalçe Drgutov** +389 70 358 486

mijalce.drgutov@dzt.gov.mk

**Martin Duvnjak** +389 75 268 517

[martin.duvnjak@dzt.gov.mk](mailto:martin.duvnjak@dzt.gov.mk)

**Albiona Mustafa Muhaxhiri** +389 72228 203

albiona.mustafa@dzt.gov.mk